

Data:24/11/2023

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “PAJISJE DHE PJSË REZERVË PËR MIRËMBAJTJEN E
AGREGATËVE E PAJISJEVE TË CENTRALIT HEC FIERZË”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): PAJISJE
TË NDRYSHME - 39300000-5.**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 60,000,000 (Gjashtëdhjetë milion) Lekë pa TVSH ose 585,765
(Pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë) Euro pa TVSH.**

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 24/11/2023 është 102.43 Lekë/Euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

b. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: “*Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”, Në Nenin 82, të LPP “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet*

Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përllogaritur të fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke marrë në konsideratë specifikën e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jete jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përllogaritur të fondit limit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2020, 2021, 2022 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.*

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të nenit 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ISO ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

a) ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;

b) ISO 14001-2015 “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”;

c) ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”;

ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” - Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse mallrat e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

ISO 14001-2015 “Sistemi i menaxhimit të mjedisit” - është e nevojshme që Kontraktori të ketë staf të vetëdijshëm për politikën mjedisore dhe pasojat e mundshme të aktiviteteve të tyre në mjedis.

Aktivitetet e Kontraktorit duhet të jenë të tilla që të kontrollohet ndikimi në mjedis dhe të përgjigjet në rast emergjence të ndikimit në mjedis.

ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” - është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e gjithë personelit të shoqërisë në lidhje me masat e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe konsultimit të punësuarve për vlerësimin e rrisqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

Argumentimi: Kërkesa në lidhje me këto çertifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij, për periudhën Shtator 2023 – Nëntor 2023 jo më pak se 3 inxhinierë nga të cilët, të paktën 1 (një) inxhinier mekanik, 1 (një) inxhinier elektrik dhe 1 (një) inxhinier elektronik

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Diplomën e inxhinierëve;
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën Shtator 2023 – Nëntor 2023.

Argumentimi: Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Kriteri i mësipërm lidhet ngushtësisht me Specifikimet teknike për objektin e kërkuar. AK duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimi me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili ti përgjigjet më së miri nevojave të kërkuara në këtë procedure

Konkretisht:

1 (një) inxhinier mekanik - Eshtë kërkuar si kriter në mënyrë që operatori ekonomik ofertues të ketë aftësinë e duhur për realizimin me sukses të furnizimit të zërave për pjesët dhe pajisjet mekanike për të cilat parashikohet të realizohen në këtë kontratë, në përputhje të plotë me specifikimet teknike, të kërkuara nga AK.

1 (një) inxhinier elektrik - Eshtë kërkuar si kriter në mënyrë që operatori ekonomik ofertues të ketë aftësinë e duhur për realizimin me sukses të furnizimit të zërave për pjesët dhe pajisjet elektrike

për të cilat parashikohet të realizohen në këtë kontratë, në përputhje të plotë me specifikimet teknike, të kërkuara nga AK.

1(një) inxhinier elektronik – Në hidrocentralin e Fierzës ka procese automatike dhe gjysëm automatike, elektronika dhe digjitalizimi është inkorporuar në të gjitha proceset elektromekanike të prodhimit të energjisë elektrike, dhe sistemet e ndryshme të monitorimit. Sa më sipër edhe pjesët rezervë që janë të nevojshme kanë edhe natyrë elektronike. Konkretisht, monitorët e ndërfaqësimit me PLC-në e agregatit ose me PLC-në e rregullatorit të shpejtesisë, dhe paisjet për komunikim kanë natyrë elektronike.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose distributor të autorizuar për mallrat objekt prokurimi. *Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (kontratë, certifikatë, deklaratë etj).*

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e autorizimeve të prodhuesve ose distributorëve se operatorët ekonomikë janë të autorizuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.5 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/ët teknik për mallrat që do të furnizojë për këtë objekt prokurimi në mënyrë që të provohet pajtueshmeria me specifikimet teknike. *Në katalog, të markohen në menyrë të qartë dhe të dallueshme mallrat e ofertuara, si edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike, me qëllim që AK të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DT.*

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë se mallrat janë të rinj, të pa përdorur.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, me anë të këtyre deklaratave AK krijon bindjen se operatori ekonomik do të përmbush kontratën bazuar në specifikimet dhe kërkesat teknike të kërkuara nga AK, duke garantuar furnizimin me mallra të reja.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

I. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Pjesët rezervë elektrike dhe mekanike janë pjesë përbërëse të sistemeve elektromekanike që janë instaluar që në fillimet e ndertimit të centralit dhe pjesa me dërmuese në kohën e rehabilitimit në vitin 2006. Duke qenë sisteme ekzistuese, pjesët rezervë duhet ti përshtaten këtyre sistemeve dhe të jenë kompatibël, në mënyrë që të jenë funksional. Sa më sipër rrjedh që për hartimin e specifikimeve teknike të pjesëve rezervë, janë marrë për referencë specifikimet teknike (dimensionet, parametrat etj) të pjesëve ekzistuese. Në tabelën e specifikimeve është vendosur emri i prodhuesit të pjesës ekzistuese për tu marrë si referencë dhe nëse prodhues të tjerë plotesojnë të njëjtat specifikime teknike, mund të merret variant ekuivalent.

Për të gjithë pjeset janë bashkëngjitur të dhëna shtesë të ilustruara me foto dhe me skema elektrike për të krijuar lehtësira për cdo operator që të njihet me cdo specifike të produktit të kërkuar.

Njësia e Prokurimit